



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE

Adresa: Rr. Reshit Çollaku" Tel. 04 234 918, Fax. 04 228 516 Email: Info@hidaa.gov.al

Nr. Indeksi	
Viti i deklarimit	2004

DEKLARIM

I PASURIVE, TË DETYRIMEVE FINANCIARE TË TË ZGJEDHURVE DHE TË DISA NËPUNËSVE PUBLIKË
(Ligji Nr. 9049, Datë 10.04.2003)

- **Kush mbart detyrimin për deklarim:**
Të gjithë subjektet (personat) që mbajnë funksionet e renditura në nenin 3 të ligjit.
- **Llojet e deklarimit, afati i plotësimit të deklaratës dhe objekti i deklarimit:**
Sipas llojit të deklarimit vendosni në kuti shenjën 'X'.
- ☐ **Deklarimi i parë apo para fillimit të punës** në një nga funksionet që të detyron të deklarosh pasurinë, duhet plotësuar brenda 30 ditëve të fillimit të detyrës.
Në këtë lloj deklarimi duhet të pasqyrohen për deri më 31 Dhjetor të vitit paraardhës të gjitha pasuritë e akumuluar ndër vite, detyrimet financiare, burimet dhe origjina e pasurisë së vetë subjektit, bashkëshortit/es dhe të fëmijëve në moshë madhore me të cilët figuron në një përbërje familjare. (Lexo nenin 6, 9 dhe 21 të ligjit).
- ☒ **Deklarimi vjetor** dorëzohet brenda datës 31 Mars të çdo viti. Në këtë lloj deklarimi duhet të pasqyrohen vetëm ndryshimet në gjendjen e pasurive për periudhën nga 1 Janari deri më 31 Dhjetor të vitit paraardhës, burimet e krijimit të tyre, si dhe detyrimet financiare të vetë subjektit, bashkëshortit/es dhe të fëmijëve në moshë madhore me të cilët figuron në një përbërje familjare. (Lexo nenin 4 të ligjit).
- ☐ **Deklarimi pas largimit nga funksioni** duhet plotësuar deri 2 vjet (2 deklarime vjetore) pas largimit nga funksioni dhe deri në 4 vjet (4 deklarime vjetore) për disa lloj funksionesh. (Lexo nenin 8 të ligjit). Llogaritja e këtij deklarimi është 31 Dhjetori i vitit paraardhës.
- ☐ **Deklarimi me kërkesë** bëhet me urdhër të Inspektorit të Përgjithshëm ndaj personave juridikë e fizikë të lidhur me subjektin që mbart detyrimin për deklarim të pasurisë. (Lexo nenin 7 të ligjit).
- **Pyetje, ndihmë dhe ku do të merret e dorëzohet deklarata:**
Të gjithë subjektet janë të detyruar të marrin e të dorëzojnë dokumentin deklarata pranë Inspektoratit të Ulët të ngritur në Institucionet ku kryejnë funksionin apo ku kanë punuar deri pas largimit nga funksioni, sipas rastit mund edhe të kërkojnë ndihmë për plotësimin e saj po në Inspektoratin e Ulët. (Lexo nenin 18, 19, 23 të ligjit).
Në qoftë se ju keni pyetje të tjera kontaktoni me ILDKP në numrin pa pagesë **0800 9999**, si dhe në numrin **234 918**.
Për më tepër informacion mund të drejtoheni në: **www.hidaa.gov.al**
- **Masat administrative:** Refuzimi për deklarim sjell humbjen e funksionit, publikimin, ndëshkimin në përputhje me Kodin Penal. (Lexo nenin 5 të ligjit).
Kur deklarata dhe dokumentet shoqëruese nuk paraqiten në afatin e caktuar, pa shkaqe të arsyeshme, subjekti gjohet me 25000 lekë. Në qoftë se deklarata nuk dorëzohet edhe 15 ditë pas komunikimit të gjobës njoftohen organet përkatëse dhe gjoba dyfishohet. (Lexo nenin 40 të ligjit).
Vërtetohet se deklarimet e bëra në vijim nga unë janë të plota, të vërteta, të sakta dhe mbaj përgjegjësi ligjore për vërtetësinë e tyre.

TË DHËNAT PERSONALE

Plotëso me gërma të mëdha

Emri	Atësia	Mbiemri
Ditmir	Sulejman	Bushati
Funksioni	Institucioni	Vendi
Drejtor	Ministria e Integrimit Evropian	TIRANE
Adresa e Institucionit		
Pallati i Kongresit, Blvd. Dëshmorët e Kombit		
Data e emërimit në detyrë	Data e largimit nga detyra	Data e dorëzimit të deklaratës
02/04		30/03/05

Nënshkrimi

Sipas nenit 34 të ligjit, të dhënat e deklaratës publikohen, përveç të dhënave të faqes 7 dhe 8.



PASURITË E PALUAJTSHME DHE TË LUAJTSHME

Në këtë seksion do të pasqyroni pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme, (në emër të deklaruesit, bashkëshortit/es dhe fëmijëve madhorë) të ndodhura brenda ose jashtë Shqipërisë deri më datë 31 Dhjetor të vitit paraardhës.

Çfarë përfshihet në pasuritë e paluajtshme:

Toka, burime, rrjedhje uji, uzina, fabrika, dyqane, shtëpi e apartamente banimi, ndërtime të ndryshme si hoteleri, pikë karburanti, magazina, pishina etj. mbi të cilat ju ushtroni një të drejtë reale, pavarësisht nëse janë të regjistruara ose jo në Z.R.P. të Paluajtshme. (Në kolonën përkatëse do të përshkruani me hollësi pronën, si p.sh. sasinë në natyrë, sip. në m², vlerën e pronës, vitin e ndërtimit etj).

Çfarë përfshihet në pasuritë e luajtshme:

Të gjitha mjetet motorike për të cilat është i detyrueshëm regjistrimi në një organ shtetëror siç janë: zyrat noteriale, tatimore, drejtoritë e shfrytëzimit të automjeteve, kapiteneria e porteve, të regjistrit hekurudhor, ajror, gjykata, banka etj. pasuritë e tjera të luajtshme si sende që kanë një vlerë të veçantë mbi 5000 dollarë amerikanë (ose ekuivalenti në çdo monedhë tjetër), aksione, letra me vlerë, gjendje cash, pjesë kapitali në zotërim, likuiditete në bankë, duke përfshirë këtu edhe depozitat për fëmijët e mitur apo personat që keni në ngarkim etj. (Lexo nenin 4 të ligjit).

Kujtesë: Në deklarimin vjetor do të pasqyroni vetëm ndryshimet e ndodhura në pasurinë tuaj gjatë një viti.

Të dhënat për pasuritë që do të deklaroni, si p.sh. numrat e regjistrave të Z.R.P.P., numra të ndryshëm të regjistrave publikë, emra të personave të cilëve u keni dhënë hua në lekë apo në valutë të huaj etj., që ju e çmoni se janë konfidenciale, do t'i shënoni në faqen 7, e cila nuk do të publikohet.

Përshkrimi i hollësishëm i çdo lloj pasurie (lexo nenin 21 të ligjit)	Vlera e secilës pasuri në lekë apo në valutë, në momentin e krijimit (e shprehur me shifra dhe me fjalë)	Pjesa që zotëron (në %, sasi apo vlerë)	Data dhe viti i krijimit të pasurisë
1 AUTOMJET	250.000 (leke) dyqindepesedhjetë mijë	100%	Prill, 2004
2			
3			
4			
5			

Deklarimi është i pavlefshëm nëse nuk pasqyroni identitetin e firmën.
Nëse kjo tabelë është e pamjaftueshme mund të vazhdoni në faqen 4.

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Dhimitër Bushati



PASURITË E PALUAJTSHME DHE TË LUAJTSHME

Përshkrimi i hollësishëm i çdo lloj pasurie (lexo nenin 21 të ligjit)	Vlera e secilës pasuri në lekë apo në valutë, në momentin e krijimit (e shprehur me shifra dhe me fjalë)	Pjesa që zotëron (në %, sasi apo vlerë)	Data, viti i krijimit të pasurisë

Deklarimi është i pavlefshëm nëse nuk pasqyroni identitetin e firmën.

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Dhimitër Bushati



DETYRIMET FINANCIARE NDAJ PERSONAVE JURIDIKË DHE FIZIKË

Deklarimi i detyrimeve financiare si kërkesë e nenit 4 të ligjit do ndihmojë në argumentimin e drejtë të pasurisë së vënë ndër vite apo gjatë një viti.

Çfarë detyrimesh do të përfshihen:

Në tabelën e mëposhtme duhet të renditen të gjitha detyrimet financiare (kredi, hua, borxh etj.) që keni patur ose keni ju, bashkëshorti/ja dhe fëmijët madhorë (që keni në përbërjen familjare) dhe që ju kanë shërbyer për të krijuar pasuri të ndryshme të paluajtshme apo të luajtshme.

Detyrimet do të shprehen në lekë apo në valutë sikurse është bërë akt-marrëveshja, të tregohet shkaku i marrjes, shuma e marrë, kohëzgjatja dhe personi huadhënës sipas tabelës së mëposhtme.

Plotësoni dy kolonat e fundit në lekë apo në valutë
(me shifra dhe me fjalë)

Përshkrimi i hollësishëm i detyrimit financiar. (shuma e marrë, kohëzgjatja, interesi bazë, etj.)	Numri dhe data e kontratës (nëse ka)	Ndaj kujt keni detyrime financiare	Shuma e detyrimit financiar (+interesa) e <u>shlyer</u> deri më 31 Dhjetor	Shuma e detyrimit financiar (+interesa) e <u>pashlyer</u> deri më 31 Dhjetor
1				
2				
3				
4				
5				

Deklarimi është i pavlefshëm nëse nuk pasqyroni identitetin e firmën.

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Dhimitër Basha



Çfarë përfshihen në të ardhurat:

Kujtesë:

Në deklarinimin e parë apo para fillimit të detyrës, subjekti duhet të deklarojë edhe të ardhurat e realizuara në përgjithësi ndër vite: personale, të bashkëshortit/es dhe fëmijëve që ka në përbërjen familjare.

Në deklarinimin vjetor, subjekti duhet të deklarojë të gjitha të ardhurat e siguruara deri më 31 Dhjetor të vitit paraardhës, si ato personale, të bashkëshortit/es dhe fëmijëve që ka në përbërje familjare.

Deklarimi është i pavlefshëm nëse nuk pasqyroni identitetin e firmën.

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Defair Bughath



**AUTORIZIM
PËR KONTROLLIN E DEKLARATËS SË PASURISË**

Në zbatim të nenit 10 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", Unë

Ditmir Sulejman Bushati

si subjekt i detyrimit për deklarim të pasurisë nën përgjegjësinë time, autorizoj Inspektoratin e Lartë/ të Ulët ose çdo person tjetër të autorizuar nga Inspektori i Përgjithshëm, të ushtrojë çdo lloj kontrolli mbi vërtetësinë, saktësinë dhe burimet e pasurive personale dhe familjare, që ndodhen brenda dhe jashtë Shqipërisë, në të gjitha subjektet, publike dhe private.

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Ditmir Sulejman Bushati

Dorëzuar më datë

30/03/05

Adresa e kontaktit

Për çdo ndryshim të mundshëm, njoftoni pranë Inspektoratit të Lartë/ Ulët.

Deklarata dhe të gjitha dokumentet që e shoqërojnë atë janë dokumente zyrtare.

Ekzistojnë sanksione ligjore administrative dhe penale në rast të fshehjes ose të deklarimit të rremë të pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë. (Lexo nenin 5, 28, 31, 32 dhe 38 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", si dhe nenin 257/a të Kodit Penal).